



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:287956

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521393

A.nr.2950/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit,, me adresë në, kundër të paditurës, Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme – Komisioni për Vendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse, me datë 26.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit,, si e bazuar.

II. Anulohet Vendimi i Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme – Komisioni për Vendosje me numër KV.Nr.1948/2019 i datës 30.10.2019 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA –së, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, të ftuara në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: flet-kthesat e datës 11.03.2024 dhe 06.03.2024).

Paditësi në padinë e tij, të parashtruar më datën 10.12.2019, dhe në parashtrësën e datës 30.06.2022 për plotësimin e padisë ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës i datës 30.10.2019 me numër KV.Nr.1948/2019 si i paligjshëm.

E paditura ne përgjigjen ne padi ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjukata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të datës 26.03.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: kopja e letërnjoftimit për, kopja e letërnjoftimit për; ankesa e dt.21.10.2019; dokumenti i dt.15.10.2019; Vendimi kontestues i dt.30.10.2019 me numër të lëndës

Gjukata konform dispozitave ligjore të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet administrative, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative dhe ka gjetur se kërkesëpadia është e bazuar.

Gjukata, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktit kontestues, nga organi i paditur, gjen se paditësit i është refuzuar kërkesa, respektivisht kundërshtimi i paraqitur si i pa bazuar.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Vendimi i të paditurës, është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar në marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: *"Paneli i Komisionit për Vendosje vlerëson se*

vendimi i marrë në shkallë të parë nga zyrtarët policorë në vendin e ngjarjes, gjatë zhvillimit të procedurës për kundërvajtje, në tërësi ka qenë siç përcaktojnë dispozitat e procedurës për kundërvajtje, përkatësisht nuk është bërë zbatim i gabuar i dispozitave të së drejtës materiale në dëm të kundërvajtësit. Kurse, sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar Paneli konsideron se dënimi i shqiptuar është i bazuar në dispozita ligjore dhe se kundërvajtësit i është shqiptuar dënimi që parasheh ligji për kundërvajtjen e kryer”.

Në këtë kuptim, gjykata gjen se e paditura, vendimin e atakuar me padi e ka marrë pa dispozitiv të saktë dhe pa arsyetim, duke cituar si më lartë, duke marrë një vendim i cili nuk përmban elementet kryesore të vendimit të përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura më lartë të Procedurës Administrative. Po ashtu në vendimin e atakuar, e paditura nuk ka theksuar mbi cilat prova konkrete e njëjta ka vërtetuar faktin se paditësja e ka ushtruar ankesën jashtë afatit ligjor, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm pa e vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata me aktvendimin e datës 13.07.2022 të pranuar me datën 18.07.2022 e ka obliguar të paditurën që në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit ti paraqesë gjykatës përgjigje në padi dhe ti dërgojë gjykatës të gjitha shkresat - provat që kanë të bëjë me këtë lëndë kontestuese. E paditura e ka sjellë përgjigjen në padi, por nuk ka ofruar asnjë provë me të cilat do të mbështeste pretendimet e saja. E njëjta nuk ka marrë pjesë as në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.03.2024, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë -kthesa e dt.06.03.2024).

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur nuk e ka provuar me asnjë provë të vetme, se ka bërë verifikimin e gjendjes faktike të paditësit. Neni 37 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se: “1.Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t’ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar. 2. Përgjigja jepet në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të padisë në përgjigje palës. 3. Në afatin e caktuar pala ka për detyrë t’i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t’i dërgojë, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës”. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se në procedurën e konfliktit administrativ, sipas ligjit të lartë cituar, ekziston detyrimi i organit të paditur që komplet shkresat e lëndës t’ia dërgojë gjykatës me përgjigje në padi dhe se ky detyrim për paditësin, nuk ekziston në asnjë nen të këtij ligji dhe se heshtjet të cilat i ka rregulluar Ligji për Konfliktet Administrative, nuk mund të zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore.

Bazuar në dispozitat e lartë cekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave të përcaktuara me ligj. Andaj, në këtë kuptim gjykata vlerëson se, e paditura ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kur as me përgjigje në padi, as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka ofruar provat me të cilat ka mbështetur vendimin kontestues, dhe si rrjedhojë, paditësit nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet rreth tyre.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprorë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr vendim të drejtë, e të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2950/2019 datës 26.03.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.